

Plani mësimor - Syllabusi

Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i shkencave të aplikuara të biznesit-Pejë
Departamenti Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri (lëndë obliguese)

Titulli i Lëndës mësimore:
Ekologji(ekologji ekonomike)

Niveli dhe lloji i kursit:
Bachelor/obliguese
Viti i II-të; semestri i III-të.

Numri i orëve në javë:
3+1

Kodi ose shifra e lëndës:
3203(obliguese),

Vlera në kredi ECTS :
6(gjashtë)

Koha/lokacioni : Çdo të martë nga ora 11.10 -13.30 salla nm. VI

Mësimdhënësi i kursit: Mehrije **Hoti**, konsultime: çdo të martë nga ora 13-14; tel. 044/137-884 ose email adresa: hoti_shle@hotmail.com

Qëllimet e kursit(modulit):

Mbrojtja e mjedisit jetësor po bëhet kërkesë gjithnjë e më e madhe për mbijetësen e civilizimit njerëzor. Levizjet e reja moderne ekologjike i vështrojnë problemet e mbrojtjes së mjedisit si qeshtje të lidhura drejtëpërsdrejti më kualitetin e jetesës.

Ndaj, qëllimi është që programi nga ky modul të ju mundëson studentëve njohjen e ndërlidhjeve midis sistemeve(nënsistemeve) ekonomike dhe atyre ekologjike përbrenda sistemit të zgjeruar ekosocial. Është nevojë urgjente për një formë të re të menduarit ekonomik. Në vend që t'i grabisim resurset e kufizuara të natyrës ne duhet të mësohemi të marrim aq sa na takon. Shtimi ekonomik duhet të suprimohet si qëllim politik, sepse ky është një barometër që tregon madhësin e ekonomisë e nuk flet asgjë për përmbajtjen e saj. Natyra asgje nuk jap falas dhe në sasi të pa kufizuar,ose gjithçka që kemi nevojë pa efektin dhe kontributin e punës njerëzore. Njerëzit duhen të punojnë dhe të organizohen për të administruar natyrën. Përdorimi i parimeve ekologjike krijon mundësi për drejtim më efikas të zhvillimit shoqëror në veçanti të atij ekonomik duke krijuar resurse njerëzore të cilat merren më zgjidhjen e problemeve të avansimit dhe mbrojtjes së mjedisit

Rezultatet e pritura të nxënies :

Pas përfundimit të ligjerimit nga kjo lëndë-modul, studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të krahason përparsitë e ekonomisë ekologjike (bashkëpunimi me natyrën), në raport më ekonominë e orjentuar në treg (ekonomia e rritjes së pa kufizuar) për një zhvillim të qëndrueshem ekonomik.

2. Studenti do të jetë i avansuar në edukim ekologjik duke i njohur faktorët dhe treguesit e ekonomisë ekologjike të cilët kanë ndikim në zhvillim ekonomik të qëndrueshem.

3. Studenti i departamentit për menaxhim në hoteljeri dhe turizem do të din të hartoj strategji dhe politika për një zhvillim të turizmit si veprimtari terciare, por gjithmonë duke ditur se si të përdorë përvojat e vendeve të zhvilluara në kushtet e shkallës së zhvillimit ekonomik të Kosovës.

4. Studenti do të kupton politikat e mjedisit në kuader të synimeve ekonomike të shoqërisë. Do të dalloj instrumentet e politikave mjedisore (sidomos instrumentet ekonomike) ;do të njoftohet për problemet globale të mjedisit;

5. Më njohuri paraprake nga shkollimi i maparshem, studenti do të rrumbullakson njohurit më këtë lëndë dhe do të vetdisoi ate dhe mjedisin shoqëror të tij. E terë kjo e bazuar në shkencë dhe arsyetim ekonomik.

Metodologjia e mësimdhënjes:

Ligjerata; seminare; diskutime; prezentime grupore; ese, për qeshtje konkrete të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë.

Literatura bazë :

1. Murteza Ismaili & Bujar Durmishi: "Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit", Tetovë 2006
2. Eban S. Goodstein: "Economics and the environment" Prentice-hall, Inc. 1995
(Përkthim kroatish nga: "MATE" Zagreb, 2003-botimi i dytë)
3. Përmbledhje e ligjeratave të autorizuara nga profesori i lëndës të plotësuar në vazhdimësi nga burime qoft në internet apo publikime të ndryshme
4. Terli Mings: Studimi i ekonomisë (parimet, konceptet dhe zbatimet)-SHLBU-Tiranë, 1993

Java e parë :

- Studimi i shkencës së ekonomisë.
- Kuptimi i shkencës së ekologjisë(ekologjia humane; ekologjia ekonomike)
- Koncepti- Kuptimi i ekonomisë ekologjike
- Edukimi ekologjik dhe vetëdija publike
- Qasje të ndryshme lidhur me mjedisin (mjedisi dhe ndotja; mjedisi dhe planeti Tokë; ndotja dhe historiku i sajë; evolucionin e ruajtjes së mjedisit; degradimi i mjedisit jetësor; vendet e pasura dhe te varfëra)

Nga ligj. e sintetizuar faq.1-5; “Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit” faqe 19-43; Studime të ekonomisë: 12-24

- **Java e dytë:**
- Rritja ekonomike dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshem
- Zhvillimi shoqëror dhe ekonomik
- Teoritë bashkëkohore të zhvillimit ekonomik
- Matja e zhvillimit ekonomik(mundësitë e matjes; qellimet; treguesit; indikatorët social; indikatorët ekonomik dhe ekologjik).
- Modelet e zhvillimit ekonomik (dallimet midis rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik; modelet e teorive bashkëkohore; modeli ekologjik).

Nga ligj. e sintetizuar faq.5-16; “Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit” faqe 83-102; Studime të ekonomisë: 55-64

Java e tretë:

- Faktoret e zhvillimit ekonomik
(Tradicionale dhe bashkëkohore; Ekonomik dhe joekonomik; E brendëshme dhe të jashtëme; Fiks dhe variabil; Faktoret me ndikim pozitiv dhe negativ në zhvillim ekonomik; Faktoret direkt (drjtpërsdrejt) dhe indirekt (të terthort).
- Zhvillimi ekonomik dhe qasjet sociale e kulturore
(struktura e familjes;Struktura klasore e shoqërisë;Religjioni;Dallimet fshat-qytet; kultura dhe institucionet shoqërore; etika dhe mjedisi jetësor).

Nga ligj. e sintetizuar faqe: 17-25 dhe 26-31

Java e katërt:

- Shoqëria dhe mjedisi
(Përpjekja e organizarave për përmirësimin e mjedisit jetësor; Ndërmarrjet industriale dhe përmirësimi i prodhimit për mbrojtjen e mjedisit jetësor).

“ Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjes së mjedisit” faqe137-157

Java e pestë:

- Etika dhe mjedisi jetësor

- Drejtësia si parim etik i mbrojtjës së mjedisit jetësor
 - Zhvillimi ekonomik dhe ndryshimet strukturore
- (kuptimi dhe llojet; ndryshimet në kërkesë; ndryshimet në tregun e punës; ndryshimet në rezultate-autput; ndryshimet strukturore dhe zhvillimi i barazpeshës)

Nga ligj. e sintetizuar fage:32-36;
“Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjës së mjedisit” fage 119-134

Java e gjashtë:

Vlerësimi i parë intermediar ,20% nga nota përfundimtare.

Java e shtatë:

- Mvarëshmeria ekonomike dhe ekologjike
- (sistemi ekologjik dhe sistemi social; ndryshimet në sistemin ekosocial; vitaliteti i sistemit ekosocial).

- Rrjedhat ekologjike dhe zhvillimi ekonomik
- (klasifikimi i rrjedhave ekologjike: ndryshimet klimatike; zvoglimi mbeshjtjedhsit të ozonit; shirat acide;kemikalet; etj)

“Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjës së mjedisit” fage 103-118; Nga ligj. e sintetizua fage37-46

Java e tetë:

- Ekonomia e mjedisit jetësor(ndotja dhe efektet e dëshme; komponentet e mjedisit; elementet lidhse të sistemit-materia dhe energjia; optimalizimi i ndotjës; aspekti ekologjik i mardhënjeve ndërkombëtare ekonomike).

Nga ligj. e sintetizua fage:46-52;
“Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjës së mjedisit” fage 83-102

Java e nëntë

- Politika e mjedisit jetësor(kuptimi;kriteret e vlerësimit; parimet;instrumentet e pol. së mjedisit më theks të veçantë në instrumentet ekonomike).
- Politika e mjedisit në BE(ISO-9000; ISO-14000)
- Globalizimi si dukuri dhe si proces shoqëror;

Nga ligj. e sintetizua fage:53-60;
Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjës së mjedisit” fage 83-102
<http://www.agimi.com>.

Java e dhjetë:

- Rregulloret shtetërore dhe mjedisore

Shoqëria dhe menaxhimi i mbrojtjës së mjedisit” fage:159-186

Java e njëmbëdhjetë:

- Strategjia e zhvillimit të mjedisit në Kosovë/korrik 2004
- Plani i Kosovës për veprim në mjedis 2006-2010
- Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit/2003/9

*Lit: MPHMM-strategjia e mbrojtjes së mjedisit;
Plani i Kosovës për veprimi në mjedis2006-2010
file://G:\per_ne.htm*

Java e dymbëdhjetë:

Vlerësimi i dytë intermediar ,20% nga nota përfundimtare.

Java e trembdhjetë:

- Zhvillimi i NVM në Kosovë dhe ndikimi i tyre në mbrojtje të mjedisit

Nga ligjeratat-material i sintetizuar

Java e katërmbdhjetë:

- Samiti i Kopenhages, (material nga shtypi ditor dhe interneti)

Nga ligjeratat-material i sintetizuar

Java e pesëmbëdhjetë:

- Përmbledhje e ligjeratave dhe debat mbi mbrojtjen e mjedisit në harmoni me aspektin e planifikimit hapsinor. Debat rreth projektit të termocentralit “Kosova e Re”.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i parë: 20%

Vlerësimi i dytë 20%

Seminare dhe prezentime 20%(10+10) më vijim të rregullt.

Provimi final: 40%

Total: 100%

Litaratura shtesë dhe bibliografia:

2. Çdo material i vlefshëm me përmbajtje nga lëmi i ekonomisë së mjedisit në hulumtimet në internet

3. Al Gore: Toka në barazpeshë(ekologjia dhe fryma njerzore), Botues: Dukagjini

4. Ligji mbi mbrojtjen e mjedisit në Kosovë;

5. Ligji mbi planifikimin hapsinor në Kosovë;

6. Publikimet e REC-it në shqip ose [http:// kos.rec.org](http://kos.rec.org)

7. www.planifikimi ekologjik

Pejë më, 01-10-2009

Mësimdhënsi i lëndës: mehrije **Hoti**